

ERIS RUSI

VASKË KOSTA,
GËRSHËRËT E ARTA TË KORÇËS

- Madhështia e një njeriu të thjeshtë -

*Biografi letrare mbi jetën e Vaskë Kostës,
njeriut të mirë, qytetarit model, korçarit krenar!*

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2024

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817860

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

Jeta nuk është gjë tjetër veçse një hije që ecën.

Një aktor i gjorë, që krekoset
dhe përpëlitet mbi skenën e jetës,
në pritje të çastit të tij, e pastaj s'dëgjohet më,
është një përrallë e treguar nga dikush,
plot tinguj dhe zhurmë, që nuk thonë asgjë.

(Shekspir U. “Makbeth”)

Për një moment, qyteti duket sikur e mban frymën në këtë fund dhjetori, 2023. Është pasdite vonë, muzgu po shtrihet ngadalë mbi çdo rrugicë, kalldrëmet mbulohen me një hije të lehtë, që shumë shpejt do të gëlltitet nga errësira. Trajtat e njerëzve në rrugë nisin të ngatërrohen me njëra-tjetrën, por gjithçka ndodh vetëm një çast, një përjetësi. Pastaj ndizen dritat festive, ngjyra e ngrohtë, e dashur, derdhet si shi dritash, që lag botën dhe njerëzit. Bulevard “Republika”, arteria kryesore e qytetit të Korçës, gjallëron përnjëherësh nga zëra dhe fytyra të qeshura, që jehojnë e ngrihen si një erë e lehtë, e dashur gëzimi, që fryn anë e mbanë qytetit. Gjithkush që vjen në Korçë në këtë moment të vitit, e ndjen që festat janë dashuri dhe përqaftim, edhe zemrat rrahin pak më ndryshe, sikur kanë tjetër ritëm dhe urimet shkëmbehen orë e çast, si për të treguar pa droje që ky është momenti më i ëmbël i vitit. *Dashuroni o njerëz, shkoni pranë familjes tuaj, mbusheni shpirtin me aromën e njerëzve të dashur, kërkonin të gjeni fjalët e buta, që e bëjnë atë pranë jush të ndjehet i veçantë dhe i dashur përherë.*

Edhe kujtimet bashkohen me dritat që spërkatën asfaltin dhe njerëzit. Kujtime njerëzish që kanë në shtëpi nënën dhe babain, bashkëshortin ose bashkëshorten, me fëmijët e mbledhur pranë vatrës

gati për të dëgjuar rrëfenja e përralla. Festë, drita dhe kujtime. Një nostalgji që kaplon gjithkënd në kapërcyell të ndërrimit të viteve. Kujtime që ndërmendin momentin e njohjes së parë, të përqaimit të parë, të puthjes së parë, zërin e kristaltë të fëmijës që lindi për herë të parë, gjithçka e bukur, e veshur me dritë e mister, për herë të parë në këtë prag fund viti, me njerëzit që i bekohen festës dhe zemrave të tyre.

Korça vishet me muzgun, edhe kujtimet të tilla i dalin, si një mall i largët, ku bën të zgjatësh duart dhe nuk prek dot ajrin, por ledhaton emra dhe fytyra që tanimë nuk janë pjesë e kësaj bote, por kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e qytetit. Në Bulevard Republika, pak pasi kalon ish kinema “Majestik”, në një godinë të re të ndriçuar gjithë kohës, mjafton të pyesësh ku gjendet “Berberhania e Vaskës” dhe të gjithë do të tregojnë me gisht ku duhet të shkosh.

Ky ambient, i lidhur pashmangshmërisht me të zotin e tij, ka qenë dhe do të mbetet një ndër hapësirat më të veçanta që mund të gjesh në Korçë. Ngjit shkallët e katit të dytë, kalon korridorin dhe me të hapur derën e berberhanes, përballesh me diçka unike, që zor se e gjen kund tjetër. Një sallë pune, e rregulluar me përkushtim, sepse Vaska i adhuronte detajet, kujdesej për gjërat më të vogla dhe në këtë ambient dha pak nga shpirti i tij, që gjithçka të shëmbëllente për mrekulli përherë.

“Vaskë”, të vjen të thuash, sikur emri mund të rikthejë në jetë atë njeri me buzëqeshjen e pandashme

në buzë, e për një moment ngjan sikur emri i shqiptuar nuk jehon bosh, por shumëfishohet; Vaskë... dhe emri sikur të jetë pjesë e natyrshme, e pandarë e qytetit, ngrihet mbi sipërfaqe e përhapet në çdo rrugicë, në çdo familje korçare, pranë çdo vatre ku ka gra e burra që qeshin, në çdo kënd ku ka njerëz që jetojnë dhe e duan këtë qytet. “Vaskë”, e një psherëtimë e thellë, të bën të mbushesh me frymë e të buzëqeshësh dhe ti?

Por cila ka qenë jeta e këtij njeriu që e donte i gjithë qyteti, e që me ikjen e tij la një zbrazëti që mbushet kohë pas kohe nga dhimbja, nostalgia, kujtimet?

Vaskë Kosta ishte një njeri i thjeshtë, i dashur, që u kthye në humbje e dhimbje për gjithë qytetin kur u largua papritur nga kjo jetë. Ndaj ky libër, me kujtime, ndodhi të vogla, të bukura, me cilësitë e pazakonta që e bënin Vaskën të dallohej nga të tjerët, synon të përcjellë pikërisht këtë mesazh njerëzit që me thjeshtësinë e tyre ngrihen përtej të zakonshmes, janë një model që kujtesa nuk duhet ta harrojë kurrë. Ai ishte një figurë që gjithkush e njihte në qytetin Korçës, një njeri që përfaqësonte njeriun e punës, me ndjeshmërinë ndaj së bukurës, me kujdesin ndaj estetikës, ndaj gjithçkaje që lidhej me jetën dhe vlerat e qytetit të lindjes.

Atë të shtunë të hidhur, që do të shënjonte përherë largimin e tij nga kjo jetë, ai e pati merak ta porosiste bashkëshorten e tij, Aidën:

- Më zgjo herët të dielën, se kam lënë orar me një klient...

Si ta mendoje ikjen e këtij njeriu? Asgjë nuk ishte e parashikuar. Përveç kujdesit të tij që të tregohej

gjithmonë i përpiktë, si gjerman, e të ishte në vendin e punës, të takohej me njerëzit dhe të hynte në biseda që kishin në thelb edhe mençuri, edhe argëtim.

Për habi, në studion e punës së Vaskës, asgjë nuk ka ndryshuar. Gjithçka është lënë siç ishte, me një kujdes të veçantë, plot përkushtim e dashuri nga familjarët e Vaskës, që ai ambient i shenjtë të mbetet i tillë përherë.

Mbi tavolinë, një libër me shkrime të ndryshme. Është i hapur, duket që është lënë kur Vaska e lexoi për herë të fundit librin. Nëse i shkon afër tavolinës, mund të lexohet paragrafi i fundit, me shkronja të mëdha, që ngjan të jetë si një mesazh misterioz lamtumire nga Vaska, në leximin e fundit të jetës së tij:

“Njerëzit i frikësohen vdekjes, më shumë se dhimbjes. Është e çuditshme se si i frikohen vdekjes, kur jeta sjell dhimbje më të mëdha se vdekja ndonjëherë. Në momentet e vdekjes nuk ka më dhimbje. Vdekja duhet të jetë miku jonë...”

Ec e gjeji shpjegim misterit të ekzistencës. Nuk ka asnjë pyetje që mund të marrë plotësisht përgjigje për atë që jemi mbi këtë tokë, për atë që bëhemi kur largohemi nga kjo botë. Por edhe sot, pas largimit të përhershëm të Vaskës, gjurmët e një ekzistence që ka lënë shenjë te njerëz pa fund, janë të dukshme. Ndaj vetiu lind pyetja: Kur njeriu largohet nga kjo botë, çfarë ndodh me ato që ka lënë pas? Vaska, me zemrën e tij të madhe dhe shpirtin e ndritur, ishte një njeri që la pas vetes një trashëgimi të pashlyeshme. Jeta e tij, e mbushur me emocione dhe përjetime, ëndrrat, dëshirat,

gjithçka që pat dashur ta realizonte ndonjëherë, lëshon rreze si dielli që edhe pasi ka perënduar, e lë dritën e tij në kujtimet dhe zemrën e botës. “Ndërsa shkoj nga kjo botë, kujtimet e mia do të mbeten si aroma e një trëndafili të freskët.”, - shkruante një poet persian për momentin kur njeriu hidhet në anën tjetër, ku misteri është i padepertueshëm për të gjallët. E kujtimet për Vaskën u kthyen në një vesë që ushqen emrin e tij në zemrat e miqve dhe njerëzve që e patën njohur nga afër.

Dhe për lexuesit që po e marrin sot në duar këtë libër, pyetja tjetër që lind natyrshëm është: Por kur njeriu ndahet nga kjo botë, çfarë ndodh me miqësitë dhe lidhjet që ai pat ndërtuar sa ishte gjallë?

Në momentet kur situatat dhe marrëdhëniet shoqërore dukeshin të ftohta e të pandjeshme, Vaska ishte ai që gjente fjalën e duhur për ta ndryshuar atmosferën, duke iu kujtuar shokëve të zemrës se ata nuk ishin vetëm, dhe se gjithçka mund të përballohej me njerëz të mirë në krah. Ai e kishte një parim që e bënte të veçantë në marrëdhënie me botën: “Lumturia është e vetmja gjë që shumëfishohet kur ndahet.”

Vaskë Kosta diti të krijonte një rrjet të padukshëm që lidhte zemrën e tij me zemrat e të tjerëve, duke qenë mbështetje edhe kur dukej sikur gjithçka po shembej nga pesha e vështirësive. Miqësinë e quante një nga dhuratat më të mëdha të jetës, si një shpirt që banon në dy trupa. Vdekja e tij i kujtoi njerëzve se jeta është e brishtë, një fije e hollë që mund të këputet në çdo moment. Largimi i papritur i tij ishte dhe një mësim për të gjithë, se vlera e vërtetë e jetës qëndron

në ndikimin që lëmë tek të tjerët, në dashurinë dhe mirësinë që mbillet për ta. Vaska jetoi plotësisht, duke dhuruar nga vetja pa kursim, duke na treguar se njeriu i mirë është ai që përpiqet të bëjë mirë për të tjerët.

Në krejt ekzistencën e vet, ai pat qenë i përkushtuar pas profesionit, futbollit, leximit, muzikës, kulturës, politikës, familjes, miqve, duke jetuar si një personazh që e bënte qytetin e Korçës të dallohej për cilësinë e banorëve të tij. Familja zinte vendin më të rëndësishëm në zemrën e Vaskës. Ai ishte një bashkëshort i dashur, një baba i përkushtuar, një gjysh i lumtur që krenohej me nipin e tij. Në punë dhe në shoqëri, ishte një shembull i njeriut që dinte të balanconte përgjegjësitë e tij profesionale dhe personale, duke i dhënë secilës fushë të jetës së tij rëndësinë dhe kujdesin e duhur.

Pasioni i madh i tij, ishte profesioni i mësuar dhe i ushtruar pa mbushur ende tetëmbëdhjetë vjeç. E ku mund të gjesh tjetër sallon berberhane i cili në çdo raft të sajën ka libra të vendosur mbi njëri-tjetrin, të gjithë të lexuara nga i zoti i saj? Ku mund të gjesh ambient tjetër, përveçse te Vaska, që katalogët e disqeve muzikore të përmbajnë nga muzika e lehtë, te ajo klasike, me emra kolosësh që kanë zbutur shpirtrat e miliona njerëzve, falë talentin dhe dhuntisë së tyre?

E ku mund të gjesh tjetër, një hapësirë që për sa e vogël edhe intime, nuk ishte vetëm një vend pune, por edhe një përvojë jete për të gjithë klientët që merreshin në dorëzim nga Vaska, e në bisedat që bënin me të, dilnin të ndryshuar së brendshmi falë komunikimit së bashku?

Salloni i Vaskës ishte ambienti ku njerëzit shkonin jo vetëm për një prerje flokësh, por për të

ndarë momente të bukura, për të diskutuar libra, muzikë, dhe politika. Leximi për të ishte një dritare komunikuese, një mënyrë për të mësuar dhe për të ndarë dije. Biblioteka e tij personale ishte e mbushur me libra të llojeve të ndryshme, nga letërsia klasike tek librat modernë, nga filozofia tek shkenca. Ai ishte gjithmonë i gatshëm të rekomandonte një libër të mirë ose të diskutonte për idetë që kishte lexuar së fundmi. Çdo libër në raftet e tij kishte një histori, dhe çdo disk muzikor një melodi që e mbushte me frymëzim.

Më tej, suvenire të vogla, detaje nga udhëtimi i Vaskës në Gjermani, nga vizita e tij në Muni, për të ndjekur Bajernin, pasionin e flaktë futbolistik që i dha gëzime pa fund me trofetë e fituara ndër vite? E çdo ndeshje futbolli, ishte si një përvojë jete, me emocione, britma, shtrëngime dhëmbësh, duartrokitje, komente, që vetëm Vaska dinte t'i përcillte si një uragan që nuk ndalej kurrë.

Por mbi të gjitha, ajo që e bënte të veçantë, ishte aftësia e tij për të ndikuar pozitivisht në jetën e të tjerëve. Ai dinte të dëgjonte, të kuptonte, dhe të këshillonte me urtësi. Çdo bisedë me të ishte një mësim, një mundësi për të reflektuar dhe për të parë botën me një këndvështrim më të hapur dhe më optimist. Ai ishte një njeri që, me modestinë dhe mirësinë e tij, dinte të ndriçonte jetën e të tjerëve, duke i bërë ata të ndiheshin të vlerësuar dhe të veçantë.

Ndaj ky libër është një homazh për një njeri të rrallë që me jetën e tij, ka lënë një trashëgimi të pasur shpirtërore dhe njerëzore. Historitë e përfshira

në këtë botim, synojnë të përkujtojnë ato cilësi që e bënin Vaskën të dashur dhe të respektuar: thjeshtësia, përkushtimi, dashuria për kulturën dhe njerëzit, dhe mbi të gjitha, aftësia e tij për të ndikuar në mënyrë pozitive në jetën e të tjerëve.

Në një kohë kur vlerat njerëzore shpesh harrohen apo shpërfillen nga rutina e jetës që rrjedh gjithë zhurmë, kujtimi i Vaskë Kostës na kujton se çfarë do të thotë të jesh një njeri i mirë dhe i dashur. Ngjarjet në këtë libër do të dëshmojnë ato cilësi që e bënin Vaskën të dashur dhe të respektuar: thjeshtësia, përkushtimi, dashuria për kulturën dhe njerëzit, dhe mbi të gjitha, aftësia e tij për të ndikuar në mënyrë pozitive në jetën e të tjerëve. Njerëzit e mirë nuk vdesin kurrë, dhe Vaska është dëshmi e gjallë e kësaj të vërtete. Emri i tij jeton në zemrat e të gjithë atyre që e njohën dhe e çmuan në jetë dhe ky libër është një mënyrë për të mbajtur gjallë atë kujtim përgjithmonë.

Profesioni

S'ka kënaqësi në jetë pa kënaqësinë që të sjell puna

Përkul dorëzën e derës dhe të duket sikur kapërcen në një botë tjetër. Korridori i vogël në të djathtë të tij mban sirtarë të vogla, të sistemuara me kujdes dhe të mbushur plot vogëlëima që lidhen me punën dhe pasionin e përditshëm. Çdo sirtar është një thesar i vogël, një mikrobotë e veglave të punës dhe kujtimeve të grumbulluara me kalimin e viteve.

Në të djathtë, dera e vogël i lë shteg një rafti të mbushur plot me libra. Një bibliotekë e vogël, por me një përzgjedhje të pasur, me kopertina që të nxitin t'i marrësh në duar e t'i shfletosh tekstet. Janë librat e preferuar të Vaskës, nga romanet klasike tek librat shkencorë, përmbledhjet me poezi, volumet historike, biografitë e njerëzve të famshëm. Çdo libër mban shenjat e leximit të kujdesshëm dhe të dashurisë për dijen.

Pastaj vjen studioja e punës, një ambient që të përfshin me ngrohtësinë dhe intimitetin e tij. Dy kolltukë profesionalë lëkure qëndrojnë krah njëri-tjetrit, ku Vaska ushtronte me përkushtim profesionin. Çdo kolltuk mban kujtimet e bisedave të pafundme, të qeshurave dhe historive të ndara me klientët. Ajo

hapësirë aq e vogël dhe intime, pat qenë si një oaz i vogël ku njerëzit vinin dhe ndjeheshin ndryshe për një hapësirë të shkurtër kohe. Si një lloj izolimi nga stresi dhe vrapi i jetës, që derdhej në botën e madhe përjashta.

Pranë dritares së lënë kapur përgjysmë, një tavolinë e vogël me disa revista që e bëjnë më të durueshme pritjen e klientëve. Revistat janë të përzgjedhura me kujdes, duke përfshirë tema të ndryshme që nga moda e flokëve deri tek kultura dhe letërsia. Një pamje e vogël e botës së jashtme depërton nëpër dritare, duke sjellë me vete freskinë dhe gjallërinë e ditëve të ndryshme të vitit.

Në qendër të studios qëndron një tavolinë e mbuluar me një vazo të madhe me lule. Lulet janë gjithmonë të freskëta dhe të zgjedhura me kujdes, duke sjellë një aromë të këndshme dhe një ndjesi të natyrshme qetësie. Ato mbushen me ajër dhe çlirojnë psherëtimë të lehta, sikur ta ndiejnë mungesën e atij që i dha jetë asaj hapësire të veçantë, në qendër të qytetit. Vazot pranë dritares janë të mbushura me gjelbërim, trajtohen me kujdes dhe dashuri nga Aida, që vjen thuajse çdo ditë këtu brenda, pas largimit të bashkëshortit, si një homazh për kujtimet dhe momentet e ndara mes tyre, një simbol i vazhdimësisë dhe i dashurisë për jetën dhe atë që ka mbetur pas, përjetësisht.

Gjithçka ngjan intime, e veçantë, e rrallë, në këtë strehëz ku Vaska ushtroi deri në fund të jetës profesionin e berberit. Çdo detaj është i menduar dhe

i rregulluar me kujdes, duke reflektuar shpirtin krijues dhe përkushtimin e tij të palodhur.

Kushdo që e njihnte nga afër Vaskën, e kuptonte sa i lidhur ishte ky njeri pas profesionit të tij. Nuk bëhej fjalë për një punë të zakonshme, që kishte të bënte me lëvizjet rutinë të dorës, të kërcitjes së gërshërëve në ajër, të përqendrimit me shprehinë e buzëqeshjes në fytyrë. Për Vaskën, profesioni i berberit ishte art, një mënyrë për të shprehur vetveten dhe për të krijuar lidhje të thella me njerëzit përreth tij.

Vaska ishte i gjithi i përfshirë pas profesionit, sepse artin, të cilin ai e donte aq shumë dhe e kishte pjesë të pandarë të jetës, medoemos që do ta përfshinte edhe në punë. Çdo prerje flokësh, çdo rregullim i estetikës së jashtme, ishte një akt krijues, një mundësi për të shprehur dashurinë dhe respektin për klientët e tij.

Kjo studio, me të gjitha elementet e saj, është një refleksim i shpirtit dhe pasionit të Vaskës. Ajo mbetet një testament i përkushtimit të tij të palodhur, një vend ku kujtimet dhe emocionet janë të gjalla dhe të pranishme në çdo cep.

Po kush ishte natyra e Vaskë Kostës në kontakt me klientët e panumërt që vinin atje brenda? Ai kishte një ndikim pozitiv në jetën e gjithkujt. Ata që nuk e njihnin më parë, shumë shpejt kishin dëshirë ta bënin mik, sepse Vaska të bënte për vete, të rrëmbente me buzëqeshjen, të ushqente me optimizmin, të çudiste me bisedat e rralla dhe të ngrohte me zemërgjerësinë e tij. *“Berberi i një qyteti të vogël është shpesh më i informuar se gazetari lokal, dhe më i dashur se prifti”*,

shprehej shkrimtari Mark Tuen, e me të drejtë këtë përkushtim, Vaska e meritonte plotësisht për qytetin e Korçës. Kushdo që e njihte nga afër, e dinte që Vaska kishte një respekt të thellë për profesionin. Gjithë jetën e kishte ngritur duke iu shërbyer njerëzve, e nuk ndalej kurrë së mësuari, përherë donte të përmirësonte teknikën e profesionit. E në një kohë kur të gjithë njerëzit nxitonin, donin me çdo kusht të mbaronin punë e të iknin sa më parë drejt punëve të tjera, salloni i Vaskës ishte si një oaz i vogël, krejt ndryshe nga çdo berberhane tjetër e qytetit. Këtu koha ndalte vetiu, Vaska përdorte si rrallëkush gërshërët dhe vetëm gërshërët. I kushtonte një kujdes skrupuloz, deri në detajet më të vogla, punës së tij, e asnjëherë nuk përfillte të vazhdonte me makinë qethëse e t'i binte shkurt, për të shumëfishuar punën dhe fitimin, siç bënin zakonisht të tjerët.

- Jo, - e kishte zakon të shprehej ai, - mjeshtëria bëhet me përkushtim dhe durim. Pa këto cilësi, edhe talenti më i madh mbetet i padobishëm.

Sikur t'i ndienin këto cilësi të Vaskës, klientët e dinin që te salloni i tij gjithçka ishte një ndërthurje e artit, shërbimit dhe shoqërisë. Vaska arrinte që çdokënd ta bënte të ndihej i veçantë dhe i mirëpritur në atë sallon. Ai krijonte një atmosferë të rehatshme ku njerëzit zhyteshin në kolltukun e rehatshëm, mbyllnin përgjysmë sytë e bisedonin me të zotin e asaj studioje, sikur të ishin në ambiente të ngjashme në Perëndim, jashtë vendit. Kur ndonjë e pyeste dhe kërkonte të dinte gjëra që Vaskës iu luhatnin humorin, se kishte

dhe njerëz që donin të dinin më tepër për punët e të tjerëve sesa për veten e tyre, Vaska i rikthehej filozofisë së tij. Mbushej thellë me frymë, kërciste gërshërët në ajër, e si një filozof në kulmin e meditimit, shqiptonte:

- Pasioni për zanatin është çelësi i suksesit për çdo berber. Ky pasion më bën të gjej kënaqësi në punën e përditshme. Por sekreti është një dhe një i vetëm: Asnjëherë mos ngatërro historitë e klientëve, duke i kaluar te klientët e tjerë! Mua më mjafton profesioni im! Unë këtë punë që bëj, e bëj sepse e dua. Ndaj kujtdo që kërkon të më ngatërrojë me thashetheme, unë i përgjigjem jo me fjalët e mia, por me fjalët e njerëzve të mençur: “Zgjidh një punë që e do dhe nuk do të duhet të punosh asnjë ditë të jetës tënde”.

Klienti kureshtar, që priste të mësonte ndonjë detaj më tepër për njerëzit që kishte interes të dinte ndonjë sekret, e shihte me sy mëdyshës nga habia. Kush ishte ky berber që i citonte njerëz të ditur, e që pastaj e shtypte lehtë në qafë dhe i thoshte të lëvizte pak majtas kokën? Berber a filozof të ishte vallë? E kur Vaska e kapte hutimin e klientit, e dinte që nuk do të kishte më pyetje për të marrë të dhëna për njerëzit e tjerë. Ndaj qeshte i kënaqur me veten dhe e çonte deri në fund punën.

Ah, kjo buzëqeshja e tij! E bënte këdo që të ndihej rehat, sikur e njihnte prej një jete të tërë atë burrë shtatlartë, me ballin e skalitur, me flokët që kishin ngjyrën e grurit të pjekur nga rrezet e diellit. Njeriut mund t'i japësh të gjitha mundësitë, e nëse nuk është i vendosur, dorëzohet, heq dorë në mes të rrugës, e ndal ritmin dhe humbet në rrjedhën e pakthyeshme të

jetës. Por kur zgjedh me dëshirë të bësh një profesion që nuk është më vetëm i tillë, gjithçka pastaj del natyrshëm dhe mjeshtërohet nga koha. Gjithçka tek profili i Vaskës, të ndërmendte atë njeri nga i cili mund të merrje përherë diçka me vlerë. Dhe zëri i tij: i fortë, kumbues, që jehonte e përplasej pas murit të sallonit, sa herë Vaska bisedonte me pasion për sportin dhe skuadrën e zemrës.

Kush ishte rutina e ditës në përditshmërinë e tij? Vaska e hapte berberhanen gjithmonë i pari. Vinte plot me gazetatat e ditës, ku binin në sy gazetatat sportive. Ai i lexonte me interes gazetatat. Ishte një ritual për të, një moment qetësie dhe përgatitjeje për ditën që do të niste. Shpeshherë iu thoshte klientëve që ishin kureshtarë për leximet e tij: “A e dini sa rëndësi ka të jesh i informuar? Kështu edhe ju do të merrni jo vetëm një prerje të mirë, në këtë sallon por edhe një bisedë interesante.”

Dhe salloni i Vaskës ishte vërtet një vend special. I përngjante një shtëpie ku atmosfera ishte mikluese dhe kushdo futej me lehtësi e dëshirë brenda. Kur ai hapte dyert në mëngjes, ndihej aroma e punës që bënte. Që në orët e para të ditës përhapeshin tingujt e muzikës, pastaj pastrimet e vogla, muret merrnin jetë, nga dritaret e hapura hynte drita e diellit dhe gjithçka ishte gati për t’ia nisur punës. Kur Vaska fliste, fjalët atje brenda kumbonin plot dashuri e pasion.

Ky pasion, kishte lindur që në moshën katërmëdhjetë vjeçare. Nëna e tij, Gallata, besonte se një njeri kur ka një zanat e ka jetën të rregulluar, kështu

që nuk ishte aspak çudi kur ajo vendosi ta dërgonte Vaskën për ta mësuar profesionin e berberit. Vaska vinte nga një familje e nderuar e Korçës, Gallata ishte me pozitë në rendin shoqëror të asaj kohe dhe përdori ndikimin dhe ndërhyrjet e saj për të siguruar që i biri të mësonte një profesion. Në vitin 1977, Vaska filloi si çirak në Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale, në sektorin e riparim-shërbimeve. Kjo ndërmarrje përfshinte disa shërbime të ndryshme, mes të cilave edhe atë të berberit. Në këtë ndërmarrje, Vaska u bë pjesë e një grupi të vogël profesionistësh ku kishte shumë humor dhe situata komike.

Mjeshtri i parë, ai që i dha të fshehtat e zanatit, quhej Raqi Domuzi, por ky nuk ishte mbiemri i tij i vërtetë, por një nofkë, siç iu vihej shpesh njerëzve në Korçë. Një njeri i kohëve të tjera, kur dinjiteti i punës ishte mbi gjithçka dhe gjërat bëheshin me përkushtim dhe seriozitet. Në ditët e para të punës pranë tij, Vaska nisi të kuptonte marrëdhënien e veçantë që lidhej me njerëzit, përmes profesionit. Raqi Domuzi ishte treguar i kujdesshëm ndaj këtij djaloshi që donte të mësonte zanatin. I shpjegonte që për të qenë një berber i mirë, nevojitej të kishe dorë të qëndrueshme dhe sy të mprehtë. Gërshëra nuk duhej të lëvizte pa kriter, lëvizjet duhej të ishin delikate e të kontrolluara. Pastaj klienti duhej të ishte qendra e vëmendjes. Një berber i mirë duhej t'i dëgjonte përherë klientët e tij. Të hynte në bisedë me ta, t'i bënte të ndiheshin të përfshirë nga biseda e bërë brenda berberhanes. Ky,

me siguri, ishte një çelës që Vaska e pat përvetësuar si sekretin e suksesit të tij.

Pas përfundimit të periudhës si çirak, Vaska u transferua te berberhania kryesore e qytetit, e njohur si “Krimia”. Ky ambient ishte vija e frontit për të gjithë ata që dëshironin të bëheshin berberë të mirë. Humori dhe gjallëria e përditshme ishin pjesë e jetës së tij profesionale. Puna si berber nuk ishte vetëm një mënyrë për të fituar jetesën, por edhe një burim i kënaqësisë dhe i lidhjeve të mira shoqërore. Klientët shpesh vinin jo vetëm për një prerje flokësh, por edhe për të qeshur dhe për të ndarë momente të këndshme me Vaskën. Kështu, ai nuk u bë vetëm një mjeshtër i zanatit të tij, por edhe një figurë e dashur për komunitetin, një njeri që me humorin dhe profesionalizmin dinte si të krijonte atmosferë të ngrohtë dhe miqësore.

Me kalimin e viteve, Vaska arriti të ngrihej mbi profilin e profesionit që ushtronte. Ai dinte t’i lexonte mirë njerëzit, por shihte gjithmonë dritën tek ata. Aq më tepër te klientët e tij. Të gjithë njerëz që i njihnte prej një jete ose njerëz të ngritur, me profesione të nderuara, që tek Vaska vinin jo vetëm për shërbimin, por sidomos për atmosferën e ngrohtë dhe miqësore që gjenin këtu. Për Vaskën, detaji ishte gjithçka. Kujdesej për gjërat më të vogla, sepse detaji bënte dallimin nga të tjerët. Kjo ishte arsyeja pse klientët e zgjedhur vinin tek ai: Vaska i kushtonte vëmendje detajeve. Në profesion, rrallë mund të gjeje dikë tjetër që të punonte në atë mënyrë si Vaska. E kishte art

mënyrën si merrte përsipër ta bënte punën me çdo klient. Zotëronte një durim të rrallë, të qethjes me gërshërë, deri në milimetra. Nuk gabonte asnjëherë, gjithçka i vinte natyrshëm, gishtat i lëviznin me shkathtësi, e nuk e tradhtonte asnjëherë gërshërën. Edhe sot, është vështirë të gjesh dikë që i kushton vëmendje detajit, për ta kthyer në art atë. Vaska ka qenë ndër të rrallët që punonte vetëm me gërshërë. E po ta mendosh sot, teknika vetëm me gërshërë, është teknikë në zhdukje. Është teknikë që merr kohë, por nuk të zhgënjën. Ashtu e mbante një orë klientin, Vaska. Ai që ulej në kolltuk, e dinte që procesi nuk kishte të bënte vetëm me prerjen e flokëve. Vaska, me durimin e tij, me këtë teknikë, me gërshërë e gishta, deri sa të dilte në 5 milimetra, bisedonte pareshtur, duke e kthyer në një mjeshtëri artistike të gjithë procesin e punës.

Janis Parios, muzika e shpirtit

Vaskë Kosta tani është i kthyer në dritë, ndoshta vjen bashkë me rrezet e diellit kur Aida futet çdo mëngjes në sallon dhe hap dritaret, ujit lulet, vendos në radhë librat, apo shfleton fotografitë, kujtimet që kanë ndarë prej një jete së bashku. Këtu brenda, asgjë nuk është jashtë vendit të vet, Gjithçka është ku i takon të jetë, e ndoshta kjo përkujdesje e Vaskës për imtësitë më të vogla, i jepte atij mundësi të linte përshtypje që në takimin e parë me njerëzit.

Dhe a është vallë e mundur që një njeri me këtë përkushtim pas profesionit, të mos kishte edhe detaje të tjera që e bënin të veçantë e të papërsëritshëm? Po të mos kishte zgjedhur zanatin e berberit, Vaska me siguri që do të ishte bërë kirurg. Ishte aq i dhënë pas dezinfektantëve, ndaj higjienës dhe pastërtisë, sa salloni i tij përherë ngjante sikur kishte dalë nga faqet e ndonjë reviste mode. Të gjithë çuditeshin kur futeshin brenda, Vaska kishte një përkujdesje të madhe që gjithçka të ndrinte nga pastërtia. Kjo ishte shenjë e krenarisë dhe edukatës së tij, ashtu siç e kanë traditë qytetarët e mirë të Korçës.

Ai kishte shije të rafinuar për muzikën, artin dhe letërsinë. Kur vinte muzikë greke, kujdesej që zëri i Janis Parios të dilte nga salloni i tij dhe të përkundte

ëmbëlsisht ajrin e qytetit. Edhe bizneset e tjera aty pranë e ulnin muzikën që mbanin zakonisht dhe hapnin dyert për të dëgjuar më mirë. Si shpërndahej ajo melodi, ai zë i thellë i Pariosit, që të bënte të të dukej vetja si i shkëputur nga të gjitha problemet e botës. E gjithë atmosfera, i ngjante shpirtit të Vaskës, një hapësirë e madhe, e mbushur me mirësi, me tinguj, me ndjenja, madhështore. Në këto raste, klientët brenda sallorit, qëndronin pa folur dhe dëgjonin. Vaska e shihte muzikën si një dritare ku mund të shihje shpirtin e njerëzve. E bukura, ajo që kishte vlerë estetike, për Vaskën ishte përcaktuese: përmes saj e kuptonte kë kishte përballë, por edhe arrinte që ta kuptonte botën e tërë rrotull tij. Nuk ishte berberi, ishte njeriu, ishte zemra e ngrohtë, shpirti i madh, që viheshin në lëvizje për klientët. Vaska profesionin e kishte si një plotësim të vetes, por nuk hiqte dorë nga këto pasione që e bënin të veçantë dhe ndryshe çdo ditë.

Tani që Vaska nuk është më, edhe ajri është bërë më i ftohtë, pa ato nota të zgjedhura që drithëronin e përhapeshin ngado, kur Vaska zgjonte me muzikë mëngjesin. Sa ndryshe patën qenë ditët në këtë ambient të ngritur me përkushtim e pasion nga Vaska. Zëri i madhërishëm i këngëtarit, që përcillte me forcë mesazhin e të bukurës në botën e madhe përjashta. Ndërsa brenda atij ambienti, një njeri që punonte dhe shijonte me ndjeshmëri të pakufi melodinë dhe tekstin e këngës.

Arti, pasioni, profesioní!

Ata që patën fatin ta njihnin Vaskën e kujtojnë për buzëqeshjen e tij të përhershme, një shprehje e butësisë dhe mirësisë që ai i dhuronte të gjithëve, pa dallim. Ishte një buzëqeshje që përçonte një ndjesi pageje të thellë dhe që të bënte të ndiheshë menjëherë më mirë. Me të, Vaska të shihte drejt në sy, dhe në atë vështrim gjeje sinjeritet, ngrohtësi dhe një ftesë për bisedë të hapur. Nuk kishte nevojë për fjalë të mëdha, sepse e gjithë qetësia dhe ngrohtësia që mbante në shpirt, rrëfeshin përmes asaj buzëqeshjeje ku pasqyrohej shpirti.

Vaska Kosta ishte një njeri që e shprehte mirësinë në çdo gjest, në çdo takim me të tjerët. Ai mbante një qetësi të natyrshme, të thellë, që rrallë gjendej në këtë botë të vrullshme e të zhurmshme. Natyra e tij ishte e butë, e kujdesshme dhe aspak e ndikuar nga presionet e kohës. Shpesh qëndronte në qoshe, i veshur me thjeshtësi, duke soditur me një vëmendje të thellë atë çka e rrethonte. Nuk nxitohej dhe nuk përpiquej të kapërcente të tjerët – përkundrazi, prania e tij ishte një ftesë për ndalesë, për të përqendruar mendjen në thelbin e jetës. Në profesionin e tij, Vaska gjeti mundësinë për të qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me njerëzit, për të ndjerë shqetësimet e tyre, për të dëgjuar

zërin e tyre dhe për t'u ofruar mbështetje. Nuk ishte thjesht një punë për të; ishte një mision, një ftesë për të ndihmuar ata që e rrethonin. Me përkushtimin dhe seriozitetin e tij, Vaska ishte një shembull i qytetarit të vërtetë, i atij që punon për të mirën e të gjithëve. Njerëzit ndiheshin të mbrojtur dhe të vlerësuar pranë tij, sepse ai gjithmonë gjeti kohë dhe dëshirë për të ndihmuar ata që kërkonin mbështetje ose thjesht një fjalë të ngrohtë.

Kushdo që njihej, herët a vonë do të ruante në kujtesë një episod ku të dilte në pah një veçori e mirë e Vaskës. Ai kishte një dashuri të sinqertë për njerëzit dhe e tregonte këtë jo vetëm me fjalë, por me veprime konkrete. Vaska e kuptonte rëndësinë e komunitetit dhe e konsideronte përkushtimin ndaj tij një mision personal. Me një dhembshuri të sinqertë, ai e trajtonte secilin që i afrohej me respekt dhe ngrohtësi, duke i bërë të ndiheshin të veçantë dhe të vlerësuar. Por Vaska Kosta nuk ishte vetëm një qytetar i thjeshtë. Ai ishte një njeri që i jepte shumë peshë shpirtit dhe kulturës. Për të, jeta nuk ishte thjesht një ekzistencë materiale, por një kërkim i vazhdueshëm për kuptimin e thellë të saj, përmes leximit, muzikës dhe artit. Leximi ishte një pasion i pandashëm i tij; ai lexonte për të kuptuar më shumë botën dhe vetveten, për të përjetuar një botë që ishte shumë më e gjerë se ajo që kishte përreth. Përmes muzikës dhe pikturës, Vaska shprehte dashurinë për të bukurën, për atë që e bënte jetën më të pasur dhe më domethënëse.

Përpikuni ta përfytyroni pak këtë skenë:

Një sallon berberhane i rregulluar me kujdes dhe shije. Berberi që vjen i pari dhe del i fundit nga salloni i punës. Dita që rrjedh ngadalë, e njëtrajtshme, me një monotonë të trishtë, sikur akoma nuk ka diçka të bukur e të veçantë, për të pritur me dëshirë më tej. E ndërkohë, në sallon, pasqyrat e mëdha reflektonin fytyrat e klientëve, duke nxjerrë në pah punën e tij të kujdesshme me gërshtë, por pasqyronin edhe një botë më të thellë, atë të përkushtimit ndaj detajeve dhe harmonisë. Nëse njeriu e vret pak mendjen, e kupton që këto elemente përsosmërie nuk mund t'i gjejë dot të gatshme, në realitet, para syve. Duhet të krijojë një botë të tijën, ku e ndjen shpirtin që mbushet me frymë, përndryshe gjithçka është e thjeshtë, e zakonitë, e pakuptimtë.

E këtu Vaska ngacmohej nga e bukura, nga ajo që nuk ishte si të tjerat, që nuk kishte lidhje me rutinën e ditës, por që përvidhej nga një tingull muzike, nga një ngjyrë pikturë, nga një varg poezie. Nën këtë dritë, njeriu i lidhur pas së bukurës, e kërkonte ta kishte pjesë të tijën edhe këtë botë. Në rastin e Vaskës, kjo prirje ishte e natyrshme. Shtëpia e tij ishte vendi ku kjo dashuri për të bukurën merrte një tjetër dimension. Muret e mbushura me piktura shëmbëllenin me një atlas shpirtëror ku ngjyrat dhe format krijonin hapësira të tjera, të ndërtuara nga stili dhe teknika e pikturës. Në to, ai nuk shihte vetëm natyrën, qytetin apo jetën e përditshme, por dallonte shpirtin e vet, i cili paqtohej me krijimin.

Kjo traditë e pasur artistike e kishte rrënjësuar të bukurën në çdo aspekt të jetës, falë piktorëve korçarë si Koço Ristani, Vangjo Vasili, Sotiraq Kuqali dhe Romeo Kallço. Vaska koleksiononte në mënyrë të vazhdat pikturat e tyre që ishin për të jo vetëm burime frymëzimi, por edhe dëshmi se arti ka fuqinë të kalojë përtej kufijve të kohës. Ristani, me stilin që i mëshonte figurës njerëzore, sillte një etikë estetike bashkëkohore ku vërtetësia dhe frymëzimi bashkëjetonin. Sytë preheshin dhe mendja niste të punonte përballë artit të këtij piktori aq të dashur për Vaskën. Ndërsa në peizazhet e Sotiraq Kuqalit, ngjyrat dhe format krijonin një paqe të thellë, një ndjenjë të përjetshme që njeriu është pjesë e natyrës dhe natyra është pjesë e shpirtit të tij. Ngjashëm, në pikturat e Romeo Kallços, ngjyrat e ndritshme dhe format e përpikta ishin një lloj harmonie vizuale që të rrëmbente dhe të ftonte në një dialog të heshtur me veten.

Nën këtë ndikim, arti nuk ishte thjesht një pasqyrë e realitetit, por një mënyrë për ta kuptuar më mirë atë. Kjo e lidhte me të bukurën e pikturës, që i mundësonte një formë për të jetuar përtej së zakonshmes. Ai shihte se si ngjyrat e një peizazhi apo delikatesa e një portreti mund të zgjonin tek njeriu jo vetëm ndjesi të thella, por edhe vetëdijen për diçka më të madhe, më sublime. Ky ngacmim, bënte që e bukura të mos mbetej një koncept abstrakt, por një fuqi që ndryshon njeriun, duke e bërë më të thellë, më të hapur dhe më të ndjeshëm ndaj gjithçkaje që është e gjallë dhe

e vërtetë. Vaska e kërkonte shpesh, edhe pa kuptuar, atë ndjenjën e përjetshme të paqes dhe harmonisë, që vetëm arti mund ta sjellë si esencë në shpirtin e njeriut. Për të, piktura ishte një pasqyrë ku shpirti takonte veten, një udhë drejt përjetësisë që vetëm e bukura mund ta ofrojë.

Me të drejtë, dikush mund të mendojë që trillet e njeriut e pranojnë edhe të bukurën si pjesë të zakonshme jetës. Ka shumë nga ata që koleksionojnë piktura, që kërkojnë të ketë të hijshëm çdo ambient të shtëpisë, që mburren dhe krenohen me emrat e piktorëve që kanë varur në mure. Por e veçanta e Vaskës ishte që ai shkrihej me këtë atmosferë. Ishte një njeri i lindur me të bukurën, ndaj e donte atë. Kjo e shtynte shpesh që të fliste për piktorët, për muzikën, për librat. Mëngjesi i Vaska Kostës niste gjithmonë me një rit të përzemërt: një ndalesë në librarinë pranë “Vodafone”, buzë bulevardit kryesor të Korçës. Në atë hapësirë të ngrohtë, e cila hapte dyert për njerëzit që kërkonin ta nisin ndryshe ditën, ai gjente gazetat e freskëta të mëngjesit, por kureshtja e tij shkonte përtej lajmeve. Raftet e mbushur me libra të rinj, të rregulluar me kujdes e pasion nga A., pronarja e librarisë, ishin një kënaqësi që ai nuk mund ta shpërfillte. A., gjithnjë e buzëqeshur, kishte një mënyrë të veçantë për të tërhequr vëmendjen drejt titujve më të mirë; ishte kthyer në një udhërrëfyese për botën e letërsisë, një mikeshë e heshtur e atyre që kërkonin ende atë kënaqësi që mund të përcillej veç nga letërsia e mirë.

Libraria, me aromën e saj volumeve të sapobotuara, ishte më shumë se një hapësirë për të blerë libra. E rrethuar nga të katër anët me dyqane ku njerëzit blinin shumëçka, por jo kohë për veten e tyre, libraria ngjante t'i bënte pikërisht sfidë këtij realiteti: njerëzit që futeshin atje, e dinin që bashkë me librat blinin edhe kohë për t'u marrë me shpirtin, e kjo nuk ishte pak për askënd në këtë botë të sfiduar nga teknologjia. Për më tepër, gjithçka ngacmohej zhurma e lehtë e bisedave, ku ngatërrohej edhe heshtja reflektuese të atyre që zgjidhnin librat. Për Vaskën, kjo atmosferë kishte një magji të veçantë. Përpara se të nisej drejt angazhimeve të ditës, ai gjente një moment për të zgjedhur një botim të ri ose për të shfletuar disa faqe që do ta shoqëronin gjatë ditës. Letërsia nuk ishte thjesht libri më i ri i dalë nga shtypi, por një dritare që të lejonte të shihje më thellë në shpirtin njerëzor, të kuptoje atë që fjalët e zakonshme nuk arrijnë të thonë.

Bulevardi ku ndodhej libraria lidhej në mënyrë të përkryer me shtëpinë e librave të qytetit. Vetëm disa metra më tutje ishte biblioteka "Thimi Mitko", një simbol i dijes dhe pasionit për kulturën, e më tej, Katedralja e cila ngrinte shpirtin drejt qiellit. Kjo harmoni, ku libri dhe shpirtërorja gërshetoheshin natyrshëm, i jepte qytetit një atmosferë unike. Për Vaskën, kjo përzierje mes kulturës dhe shpirtit ishte thelbësore; në këtë qytet, libri dhe besimi nuk ishin thjesht dy botë që komunikonin lehtë mes tyre, por dy fytyra të së njëjtës ndjenjë, për të bukurën dhe të përjetshmen. Letërsia kishte fuqinë të ndryshonte

njerëzit, të hapte horizonte të reja dhe të kthente dhimbjen në kuptim, përvojën në urtësi dhe ëndrrat në një realitet që nuk vdes kurrë. Në faqet e librave që zgjidhte, Vaska gjente historitë e njerëzve, dilemën dhe bukurinë e ekzistencës, të gjitha të rrëfyera me atë forcë që vetëm fjala e shkruar mund të bartë. Ai e ndiente që letërsia kishte një detyrë të heshtur: të frymëzonte, të ndihmonte, të hapte shtigje aty ku mendja e zakonshme shihte vetëm mure.

Ndaj, çdo mëngjes në librari i përngjante një takimi të heshtur me letërsinë. A., me rekomandimet e saj të kujdesshme, ishte bërë një pjesë e pandashme e kësaj përvoje, duke i sjellë Vaskës libra që i zgjeronin jo vetëm mendimin, por edhe shpirtin. Në këtë cep të Korçës, ku çdo rrugë frymonte kujtime dhe çdo hapësirë mbante në vetvete një histori, libri ishte një shoqërues i përjetshëm. Përmes tij, Vaska gjente harmoninë e jetës, atë ndjenjën e fshehtë që e lidhte me qytetin, me kulturën dhe, mbi të gjitha, me vetveten.

I grishur nga kjo atmosferë, përpiqem të përfytyroj bisedën e Vaskë Kostës me poetin Skënder Rusi, që i shkroi Korçës “Një fjalë dashurie”. Sa ishin gjallë, kishin një miqësi të bukur, e Vaska ishte i pari që merrte librat e sapodalë të poetit. I lexonte, pastaj i vendoste në një raft të veçantë, më vete, raftin e Skënder Rusit. E tani që të dy janë ndarë nga kjo jetë e janë bërë dritë, le të provojmë të imagjinojmë si mund të ishte një takim mes tyre, poeti dhe berberi që takoheshin përsëri...

Ja ku janë, në atë pjesë të kohës kur nuk ka rëndësi jeta apo vdekja, tek japin e marrin me njëri-tjetrin. Poeti Skënder Rusi me brishtësinë e tij, përcillte ndjesinë e një njeriu të çuditshëm, të butë e të fortë njëherësh, që dëgjon, por që reagon hap e mbyll sytë, në moment. E poeti i thotë:

- Po të ishin të gjithë njerëzit si ty, do të ushqeheshin me mirësi, jo me inat e mëri, Vaskë!

- Poet, ti dalëngadalë do të bëhesh mbrëmje, por jo në poezitë e tua. E kushdo që ushqehet nga letërsia, nuk bëhet errësirë e plotë, as kur vdekja thërret.

Poeti buzëqesh, nënshkruan librin që Vaska e mban në dorë e i thotë:

- E di që jeta është ajo që më nxit të shkruaj edhe kur jam i dëshpëruar? Më ndodh ndonjëherë të shoh ketra të gjelbër, që presin të bëhen vargje sa herë marr stilolapsin në dorë. Por jeta... Jeta nuk mbaron me kaq, unë e di që do të ik, e pas meje, do të mbetet prapë një pjesë e imja, që jam unë...

Vaska mendohet. Nuk ka asnjë veç atyre të dyve në sallonin e mbuluar nga heshtja.

- Edhe unë do të jem në çdo libër që kam prekur me dorë. Do të jem në gjithçka ku kam dashur të vë pak nga shpirti im. Poet, njerëzit janë të çuditshëm, mendojnë që ligjet e jetës, vlejnë edhe për jetën pas vdekjes. Por ky është absurd, e nuk ka kuptim.

Për herë të parë, poeti vë buzën në gaz. Edhe ai, edhe Vaska, nuk jetojnë më, janë fryt i kujtimeve që derdhen nga njerëzit që i kanë dashur më shumë në jetë. E prapë, si personazhe, janë aq të gjallë sa mund të preken me dorë.

- E mban mend vdekjen tënde? - e pyet poeti duke i marrë nga duart librin me poezi “Dalëngadalë unë po bëhem ikje”.

- Jo, - i thotë Vaska. - Por e di që kam lënë një dhimbje të thellë te njerëzit që më duan. Akoma nuk po mësohen që përtej jetës, është një mur i hollë xhami ku ne i shohim të gjitha.

- Pikërisht, - ia kthen poeti. - E në këtë botë ku shumëkush i di të gjitha, asgjë nuk është ashtu siç duket. Të tjerët, ata që marrin frymë, mund të vijnë e të ngushëllojnë familjen, por pastaj dita e tyre vazhdon normalisht. Dikush do buzëqeshë, njëri do të lëshojë një batutë, pastaj janë telashet e jetës, detyrat, përgjegjësitë.

- Edhe ti jo pak të lehtë e paske pasur të ndahesh nga kjo botë... - i buzëqesh Vaska poetit që ka ndërruar jetë tashmë. - Por edhe në botën tjetër, një prerje e mirë flokësh s'do të bënte keq!

Qeshin të dy. Poetit i vjen të ngrejë dorën e të krehë flokët e ajërt, fjalët e Vaskës janë të pakthyeshme në këtë drejtim. Pastaj mbushet me frymë, e duket sikur brenda gjoksit të tij të gjitha retë e qiellit përthithen e zënë vend. Do që të thotë diçka. E nga buzët i kumbojnë veç vargjet e poezisë, të shkruar prej tij sa qe gjallë: “Kur vdiqa unë...”

KUR VDIQA UNË

*Më hodhët dhé sa mundët,
Më ngjeshët,
Më vutë një mal përsipër!
Më pas ca lot,
Më pas ca lule artificiale,
Më pas, më latë e ikët!*

*Më pas i latë duart,
(nga dheu
edhe nga unë!)
Dhe shkuat,
Drekuat(!)*

*Dhe nisët
Të qeshni përsëri,
Të thoni barsoleta banale,
T'i shkelni syrin njëri-tjetrit
Me djallëzi!
Ç'aktorë horrorë!
Në tërë këtë lojë
Me gjoja dashuri!*

*Veç nëna,
Eh, nëna!
Hyri fshehtaz atje, brenda,
Si një rreze dielli në dimër!
Për të ndarë me mua,
Gjithë atë mal dheu,
Që më vutë përsipër!*

*Veç nëna tani,
Me zogjtë e gishtave,
Më çuket si dikur,
Më shpupuris flokët!
M'i thërret
Me emra,
Shokët...*

Çfarë dialogu i papërsëritshëm mund të ishte kjo shkëmbim bisedë, në Parajsën e qiellit ku gjenden poeti dhe berberi. Mjafton që imagjinata të ndjekë këtë lojë, e gjithkush mund ta kuptojë që në qytetin e Korçës, kanë jetuar dhe kanë lënë gjurmë njerëz që e kanë dashur me shpirt profesionin, e që janë përpjekur të lënë gjurmë në kalldrëmet e qytetit.

E poezia, vargjet që shënjojnë zemrën, mund të kthehet në çelës për të lexuar çdo gjendje shpirtërore!

Ah, nëna, e dhimbja e ikjes... Ah gruaja, kur ndahesh nga jeta aq papritmas... Ah bija, kur e di sa e dhimbshme do jetë të zgjohesh çdo ditë, pa përqafimin e atit tënd... E këto fjalë të imagjinuara, treten në ajër, e lënë një gjurmë të bardhë, që i përngjan vijës që lënë avionët në qiell. Atëherë kur gjithçka ngjan të harrohet nga koha që rrjedh e pandalshme, e kapërcen fytyra, emra, ndjesi, pikërisht në këtë paradoks, ajo që i jep kuptim ekzistencës është modeli i njerëzve që kanë jetuar me dinjitet e respekt në këtë botë. Në anën tjetër të xhamit, aty ku ne nuk mundemi të shohim dot përtej, është gjithë mirësia e njerëzve që kanë jetuar e janë përpjekur të krijojnë një shteg që të jetë

si model për ata që do të vijnë pas. Ndokush mund të mendojë që e ka fatin dhe jetën të mbyllur në grushtin e vogël të tij, por jeta tregon që mund të marrë e të çojë në anën tjetër edhe më të mirët, më të dashurit, më të vlefshmit. Ndaj, për njerëzit që kërkojnë të lënë gjurmët e tyre në këtë botë, mirë është të buzëqeshni, të lexoni e t'i gëzoheni shpirtit tuaj, të lini gjurmë, sepse një apo njëqind vjet janë shumë pak për botën tonë. Thoni nën zë: "Perëndi e madhe", e qeshni me madhështinë e atyre që nuk e njohin ende kufirin e qiellit mbi krye...

Gjithkush mund të thotë se njeriu bën një profesion dhe paguhet për të. Një berber është i respektuar për punën e tij kur klientët mbeten të kënaqur me prerjen e flokëve apo modelin e zgjedhur. Por nuk ishte vetëm kjo për Vaskën. Kishte diçka të thellë, të veçantë, brenda natyrës së tij. Vaska i gjendej kujtdo. Janë ca njerëz, që sado të thjeshtë ta kenë profesionin, sado të qetë të duken prej së largu, i bëjnë mirë shoqërisë, qytetit ku jetojnë. Vaska ishte një prej tyre. Po të pyesësh miqtë e ngushtë të tij, do të thonë që një nga cilësitë më të veçanta të Vaskës, lidhej me natyrën e qetë dhe mirësinë që nuk e ndante kurrë prej vetes. Mirësjellja ishte një formë për t'iu avitur botës. Asnjë nuk e ka dëgjuar ndonjëherë Vaskën të shajë apo të thotë diçka të keqe me mllef. Ai nuk pranonte të prishej me fjalë me botën, ishte i dashur me të gjithë. Kur i tregoje diçka personale, ku mund

të ishte në mesin e një konflikti e do të mjaftonte një fjalë për të ndezur sherr me dikë tjetër, shpeshherë ai gjente mënyrën e duhur për të pajtuar situatat. Të shihnte i menduar, e pastaj i nxirrte me kujdes këshillat nga vetja duke thënë: “Lere... të mendohet... në një moment të dytë do pajtohet me ty. Mos u trego dashakeq me njerëzit.” Ai i jepte kohë kujtdo, e koha do të sistemonte gjithçka, do të ndante të vërtetën nga gënjeshtra, të mirën nga e keqja. Vaska me një njeri që komunikonte, krijonte besim. Ai zotëronte një intuitë të jashtëzakonshme dhe rrallëherë mund të gabonte në përcaktimin e gjërave. Pranonte të vihej përherë në shërbim të të tjerëve, e ato që të thoshte, t’i përcillte i qartë. Nuk zgjatej, nuk humbiste në fjalë të kota, por të tregonte pak gjëra kyçe, që vlenin, e nuk të lodhte. Kur i hapeshe për diçka, Vaska të linte kohë ta zgjidhje situatën. E bënte me këdo këtë gjë. Nuk të ngjitej, të të pyeste orë e çast si po të shkonin punët. Ndodhte që të të pyeste pasi kish kaluar një muaj i plotë për një histori të treguar më parë. Nuk kishte kuriozitet të sëmurë. Të linte të merreshe me veten. Sa fjalë janë thënë brenda sallonit të tij, e sa kanë dëgjuar muret atje brenda... Vaska dinte të dëgjonte, dinte të këshillonte, por nuk të nxirrte asnjëherë zbuluar tek të tjerët. Ai respektonte te çdo klient, privatësinë e tij. Kishte nga ata që e ngacmonin, donin të dinin më shumë, të merrnin vesh ndonjë detaj edhe për njerëzit me emër që ishin klientë të tij. Por Vaska i kishte buzët e kyçura në ato raste: “Kot e ke, ti më pyet e do të dish, por po të tregoj për të tjerët, do të më duhet

t'iu tregoj edhe atyre për ty, e unë nuk e bëj këtë", i përgjigjej atij që e pyeste me kureshtje, e biseda ndryshonte menjëherë drejtim.

Për më tepër, ai përshtatej me njerëzit, me çdo moshë, me çdo gjini, me vajza të reja, me gra në moshë, me fëmijë, me pleq. Prandaj dhe lidhja me një njeri si Vaska ishte speciale për të gjithë që e njihnin... Ata që hynin në sallonin e tij ishin si një familje, si një shtëpi e vetme, që ka kuzhinën, sallonin, e merreshin vesh. Klientët hynin në berberhane, e iu dukej jo sikur kalonin korridorin e vogël për t'u ulur në karrigen rrotulluese, por sikur rrëshqisnin nga një dhomë në tjetrën brenda të njëjtës shtëpi. Pastaj Vaska... ai i bënte të gjitha të thjeshta për klientët. Sa humbje e hidhur dhe sa e rrallë është që ta gjesh sot një njeri me cilësitë e tij... Çdo mëngjes të përshëndeste i pari, në mbremje të thoshte natën e mirë. Edhe po të ishte mbyllur dera e bizneseve ngjitur, e hapte dhe e bënte si ritual. Ai donte që të linte fjalën e mirë tek fillimi dhe mbarimi i ditës. Ishte i veçantë, i miri Vaskë, kishte aq përkushtim, edhe në gjërat e thjeshta, ato që vërtet i japin kuptim jetës. Një njeri që madhësinë e zemrës, e shpërfaqte në thjeshtësinë e të jetuarit në paqe me botën. I madh, në thjeshtësinë e tij...

Modeli i Vaskë Kostës është i rrallë sot, por ai duhet të frymëzojë çdo shoqëri që kërkon të rikthejë një lidhje të thellë me të bukurën dhe kuptimin. Në një kohë kur shpesh profesioni përkufizon njeriun, Vaska tregonte se është pasioni ai që e përcakton atë. Ai na kujton se çdo njeri, pavarësisht nga puna që

bën, mund të jetë një artist në shpirt dhe një krijues i bukurive të vogla që ndryshojnë jetën e përditshme. Për Vaskën, letërsia, muzika dhe piktura ishin forma të besimit tek njerëzorja, tek potenciali i njeriut për të parë përtej dhe për të ndërtuar një jetë që rezonon me ndjenjën më të lartë të përjetimit.

Ndaj kushdo që e kujton sot, e ndjen si i shfaqet në përfytyrim fytyra e tij me një buzëqeshje e madhe: është drita e shpirtit të Vaskës, gëzimi që lodronte në fytyrën e tij. Të mirit i qeshnin sytë, buzët, krejt pamja. Lexohej i gjithi, sepse nuk fshihte e nuk kishte asnjë maskë për ta ndërruar me një tjetër. Ai ishte vetvetja. Kjo filozofi për jetën dhe marrëdhëniet me njerëzit e bënte Vaskën të veçantë. Ai ishte një njeri që besonte fort në drejtësinë e tokës, por edhe në atë të Qiellit. Njerëzit e mirë, janë njerëz të Zotit, e Vaska besonte me shpirt. “Perëndi e madhe”, thoshte shpesh, sepse e ndjente që nuk mund të zgjidheshin të gjitha mbi këtë botë, ca gjëra të lëna në mes, do merrnin zgjidhje në botën tjetër. Besimi i tij buronte nga brenda shpirtit, e kishte të natyrshme dhe ndoshta ndaj sot e ka vendin mes shpirtave të mirë, pranë Perëndisë...

Perëndi e madhe!

Këto ishin fjalët që Vaskës i buronin nga shpirti. Nëse i shqipton sot, po ato fjalë, brenda sallanit, e ndjen se si tingujt mbeten atje pezull, solemnë, nuk dalin nga dritarja, na lënë të kuptojmë që jemi të gjithë kalimtarë, të përkohshëm, në këtë botë.

Besimi në Zot është një regëtimë shprese për çdo shpirt të ndjeshëm, që jeton me rregullat e dashurisë, përkujdesjes për tjetrin. Që i vë vetes detyrë të jetë i

dobishëm, të mos bëjë keq, të krijojë me ekzistencën e tij një shembull ku gjurmët të mos treten lehtë në kohë. Çdo qenie njerëzore është e pafuqishme përballë misterit që bart brenda vetes, që në momentet e para të lindjes. “Perëndi e madhe!”, për të treguar që gjërat nuk janë në duart tona, që planet e qiellit kanë pushtet mbi gjithçka që kujtojmë se mund apo duhet të bëjmë në tokë. E nën këtë dritë, natyra e njeriut që beson është e përulët ndaj qiellit, ndaj Zotit, ndaj gjithçkaje që mbush me dritën e Perëndisë edhe kthinat më intime të shpirtit. “Perëndi e madhe!”, edhe kur gjërat nuk shkojnë siç duhet, kur jeta të përplas pas shkëmbinjsh të thepisur, në situata ku zor se gjen shpëtim dhe e vetmja gjë që të ngelet, është që të çosh sytë lart, drejt fronin qiellor. E gjithë kjo atmosferë, brenda Vaskës ishte e përcjellë në mënyrë të natyrshme nga familja, nga të jetuarit në një qytet si Korça, që ka respektuar përherë traditën e besimit dhe e ka përcjellë si një model të shëndetshëm, brez pas brezi, edhe në kohët e errëta të diktaturës, kur sistemi dënoi me ligj aktin e besimit. Ndoshta ky element e shpjegon edhe mirësinë e përhershme të Vaskë Kostës kundrejt të tjerëve: të besosh, do të thotë të jesh në shërbim të njerëzve, të japësh, pa pritur që të marrësh gjë mbrapsht, në kthim. Perëndi e madhe... Perëndi!

Një zhurmë e furishme jete hyn nga dritaret e hapura të berberhanes. Janë britma fëmijësh që qeshin, plot jetë, e i gëzohen moshës. E qeshura depërton brenda, e përplasat në muret e bardhë, si shenjë që Vaska iku, por buzëqeshjen e la si dhuratë për ata që i pat dashur aq shumë në jetë.

Dhimbje dhe mall

- *Të mirët i merr të parët Zoti!* - mërmërit K., një vajzë e re që e ka ambientin e saj të punës në të njëjtin kat ku gjendet dhe salloni i Vaskës. Ajo ka nevojë të tregojë dhe dhimbjen e saj, si e mori vesh lajmin e hidhur të ndarjes së papritur nga jeta të tij.. Ajo është një nga njerëzit që e njihte dhe e përjetonte praktikën e punës së përditshme në sallon. K. ka një energji që shpërfaqet në gjithçka që bën. Krahët e saj janë të zbukuruar me tatuazhe, një shenjë lirie dhe rebelimi që lidhet me moshën dhe natyrën e saj. Kundrejt Vaskës, portreti i saj ishte krejt i kundërt: Vaska ishte i paqtë, i rregullt dhe i kujdesshëm edhe për vijën më të vogël të këmishës, ndërsa K. ishte një shpirt i lirë që nuk mëdyshej t'i thoshte kujtdo atë që i kalonte në mendje. Gjallëria nuk i ndahet një moment nga sytë, që lëvizin e kërkojnë me ngulm të gjejnë përgjigjet e duhura në çdo situatë. I trokas në derën e sallonit, e i shpjegoj me pak fjalë që do të kisha dëshirë të shkëmbeja një bisedë me të, në lidhje me Vaskën.

Kur përmend emrin e tij, fytyra e saj trishtohet, sikur t'i ketë kaluar përsipër një re e zymtë qielli. Megjithatë e mbledh shpejt veten dhe tund kokën në shenjë pranimi.

- Sa mirë, - i them dhe pastaj i shpjegoj që bisedën do të bëjmë në berberhanen e Vaskës. Sikur kjo të

ishte gjëja më e natyrshme e botës, K. tërheq për të mbyllur derën e sallonit të saj dhe kapërcejmë korridorin, futemi në botën e dikurshme të Vaskës, ku gjithçka ka mbetur e paprekur, që nga ikja e tij. I them të më tregojë një detaj që i ka bërë përshtypje dhe nuk e harron nga takimet e përditshme me Vaskën në sallonit e tij. Ajo pa humbur kohë, më thotë:

- Më kujtohet që një ditë erdhi të më takonte një mike e imja, që kishte dëgjuar për Vaskën e kishte shumë kuriozitet ta shihte berberhanën e tij. Unë e thashë, ai nuk ishte një ambient i zakonshëm ku njerëzit shkonin të rregullonin flokët; atje kishe muzikë, libra, art, pasion, përkushtim. Ndaj mikja ime, që kish dëgjuar të flitej aq shumë për Vaskën në bisedat tona, erdhi e vendosur që ta shuante kuriozitetin. I thashë që do të shkoja t'ia kërkoja Vaskës nëse ishte e mundur t'i bënim një "vizitë të shpejtë". E dija që kishte një klient në atë orar. Kur ia tregova dëshirën e mikes sime, e la mënjanë gërshërën, ndërpreu punën dhe në mënyrë instinktive, pa u menduar, filloi t'i shtynte me këmbë qimet e flokëve në dysheme. Sikur shoqja ime do të hynte nga çasti në çast e do ta gjente të papastër sallonin e tij. I tillë ishte Vaska, edhe në fluks të punës, donte që gjithçka të ndriste nga pastërtia, e ai të krenohej me vendin e tij të punës. Kur ia tregova shoqes episodin, qeshëm të dyja e pasi u fut të shihte nga brenda berberhanen, më dha të drejtë: Ishte një ambient i veçantë, me një njeri të rrallë e të papërsëritshëm si Vaska, për pronar të tij.

E përfytyroni dot skenën me Vaskën që kapej në befasi, e nxitonte të shtynte me këmbë, të fshihte nga

sytë e botës, atë që ishte e pamundur të fshihej në një ambient pune si berberhania? K. e pat njohur si profesionist, si mik, si njeri i të bukurës. Dhe Vaskës i pëlqente e bukura mbi gjithçka!

- E ndiej akoma si shtrëngim në zemër kur e kujtoj marrjen e lajmit, - rifillon të tregojë ajo. – Në parukerinë time erdhi një klient italian erdhi dhe pyeti: “Ku është Vaska?” Kishte rezervuar takim atë ditë, por Vaska nuk ishte paraqitur në punë. Ku ndodhte ndonjëherë që Vaska të mos vinte në punë? E Aq më tepër kur kishte lënë takim më parë? Mua nuk më shkoi asgjë e keqe në mendje në fillim. Mendova se ndoshta ishte në kafe, dhe i rashë telefonit, ai përgjigjej përherë. Kur e mora dhe nuk u përgjigj, mendova mos kishte ndonjë problem me të atin. Vaska kishte një lidhje shumë të fortë me familjen e tij. Nuk kishte kaluar shumë kohë nga vdekja e nënës, ndaj merakun për të atin na e tregonte edhe ne në punë. Megjithatë nuk mora asnjë sinjal, që të kuptoja se çfarë kishte ndodhur realisht. Më vonë, po atë ditë, më shkruan një mik: “Vaska... atak kardiak... iku...” Unë me idenë që kishte shkuar në Tiranë, në spital... “Mos vallë do të shkojë në Tiranë dhe atje do ta marrë shpejt veten!”, mendova. Vaska nuk abuzonte kurrë me asgjë, as cigaren nuk e pinte. Shëndeti i tij ta bënte me sy, ta kishe zili, aq i fuqishëm ishte. Por miku që më shkroi, e dinte të vërtetën dhe nuk ma tha menjëherë. Ishte një tragjedi për mua, për ne të gjithë. Një shok i Vaskës, doktor I., vinte enkas nga Tirana për t’u qethur tek ai. E merrte në telefon: “U

Nisa Vaskë!”, dhe ky i linte orar, sepse bashkë me punën, ishte edhe miqësia, bisedat, ajo atmosferë që doktor I. e gjente veç te Vaska. Kur ndodhi tragjedia, doktori erdhi në Korçë, madje erdhi deri në pallatin tonë, ku gjendet salloni i Vaskës. U ngjit deri në gjysmë të shkallëve, por nuk i bëri zemra të shkonte e ta shihte bosh sallonin, pa mikun e tij. U kthye pas, i mbërthyer nga dhimbja e trishtimi.

Sa njerëz që e kanë dashur Vaskën me shpirt, sot kur kalojnë afër pallatit ku gjendet salloni që frekuentonin dikur, nuk guxojnë të ngrenë kokën dhe të shohin kah dritareve të lëna hapur nga Aida, bashkëshortja e Vaskës? Ngjan sikur dhimbja përmbyt çdo emocion tjetër, një pikëllim që i bën njerëzit të nxitojnë hapat, sikur të duan t’i shmangen lajmit të kobshëm që Vaska tanimë nuk është më. Por harrojnë që ajo dhimbje, ai hutim, ajo plagë që ndiejnë së brendshmi, bën që Vaska të vijojë të jetë i pranishëm, i gjallë, i paprekur dhe i patjetërsuar nga ikja, sepse jeton te gjithkush që e mendon dhe brengoset për ikjen e tij. I tillë është ligji i jetës, jetojmë si njerëz që vjen një moment e kthehen në dritë, lënë emrat dhe gjurmët në këtë botë, por nëse kanë qenë të veçantë e plot mirësi, nuk braktisin asnjëherë zemrat e njerëzve të tjerë. Krejt ekzistenca e njeriut, kështu, kthehet në një sëmbim në shpirt, që në fillim dhemb, lë plagë, pastaj kthehet në një shenjë që të kujton për dikë që nuk është më mes nesh, por që ende vazhdon të jetë, mes nesh.

M'u bëfshin kurban...

Merrni një ditë të zakonshme nga jeta e njeriut, e atje do të lexoni shpirtin e tij. Tek përditshmëria, gjëra te vogla, përshëndetjet, gjestet, mund të lexohet bota e brendshme e gjithkujt. Le ta përfytyrojmë pak, si ishte një ditë e zakonshme e punës për Vaskën. Ai zgjohej herët dhe i falej Zotit, pastaj me mirësinë në zemër, kapërcente rrugën për te pallati ku gjendej berberhania e tij. E sa gëzim të madh i pat dhënë krijimi i atij ambienti që e kishte dashur ta kishte të tijin, një ëndërr që vetëm para pak vitesh arriti ta realizonte. Më bie ndër mend mbështetja e madhe që Vaska gëzonte në qytet. Miqtë e kishte të mirë, të dashur, zemërgjerë, siç ishte edhe vetë natyra e tij. A. Dh., një nga miqtë e ngushtë të tij, në kohën kur ndërtoi pallatin ku sot është salloni i Vaskës, e mori dhe i tha, pa hezitimin më të vogël: ***“Këtë hyrjen në kat të dytë, do ta kesh ti! Është dhuratë nga mua, për duart e arta që ke, e për shpirtin që nuk ka të dytë!”***

Gëzim i madh për Vaskën, që do të kishte më në fund një ambient që ta bënte siç ia kishte atij ënda. Dhe ky lajm i dha gëzim dhe energji të pakufizuar. Për këtë projekt u angazhua një nga arkitektët më të njohur të Korçës, një mik i vjetër i Vaskës. Arkitekti, i njohur për përkushtimin e tij ndaj detajeve dhe për

aftësinë për të sjellë në jetë ambiente fine e të veçanta, mori përsipër të projektonte duke nuhatur vizionin e Vaskës. Kështu, ai ambient nuk do të ishte vetëm një hapësirë fizike, por një reflektim i shpirtit të pronarit të tij.

Vaska u përfshi thellësisht në procesin e ndërtimit, duke qëndruar në kokën e punimeve sikur të ishte duke ndërtuar një pjesë të shpirtit të tij. Ai nuk i ndahej dy vëllezërve marangozë, që punonin pa pushim, për të mundësuar detajet e sallonit sipas shijes dhe dëshirës së Vaskës. Me ta e pinte edhe kafën e pushimit dhe bënte gjithçka që ai ambient të zbukurohej me shije dhe klas, siç e pat ëndërruar përherë. Dhe vetëm për sallonin e tij, kur po merrej me ristrukturimin e ambientit, u dëgjua të ngrihej zëri në kupë të qiellit. Ishte ditë pune dhe Vaska po jepte e merrte me zë të lartë, bërtiste si tenor operash, në telefon. Nuk i dilte e keqja që s'ishte bërë puna siç duhej nga ustai i kangjellave, për të vendosur vazot e luleve të varura nga dritarja. Ndërkohë që tjetri justifikohet në telefon, Vaska i fliste vetes me zë të lartë: *“Po ke parë ti kështu? I dhashë lekët: Sa do? Kaq! Na dhe më shumë, por punën bëje si duhet. E Puna është bërë për dreq...”*

Pastaj, si me të rënë të lapsit, pushoi një hop. U dëgjua e qeshura e tij që zbuti krejt ambientin dhe ustai i kangjellave përfitoi nga situata dhe e mbylli telefonin. Ja, i tillë, ishte Vaska, e brengosnin edhe gjërat më të vogla, por me buzëqeshje i rregullonte të gjitha pastaj.

Në fund, ia doli mbanë e kjo ishte kënaqësia më e madhe. Ndërtoi ëndrrën e jetës dhe pas inaugurimit, edhe në ditët më të zymta, kur jashtë qielli ishte i zënë me re ose kur binte shi, ai shkonte atje dhe buzëqeshja i dilte nga shpirti. Puna e ngazëllente, e bukura i jepte forcë, jeta e nxiste të buzëqeshte. Por fillimi nuk ishte krejt i lehtë. Vaska priste që shumë njerëz të bëheshin klientë të tij, por në ditët e para, as një pjesë e klientëve të dikurshëm nuk po vinte. E çuditshme, por ndonjëherë njerëzit këtu tek ne ngurrojnë nga e bukura, apo i shmangen punës dhe suksesit që arrijnë të tjerët. Po ta mendosh thellë, nuk është çudi që njerëzit që të kanë ndjekur kur ishe në kushte jo fort komode, më pas të ndjehen si të tepërt, apo të mos duan të bëhen pjesë e suksesit tënd, kur më në fund ia del në krye. Por shpjegimin, me mënyrën e tij, të nënkuptuar, e jepte vetë i zoti i punës. Kur i takonte të bënte gëzuar apo të ngrinte dolli me ndonjë gotë në dorë, ai thoshte me të qeshur: *“Eh, m’u bëfshin kurban... - dhe e pinte me gllënjka të vogla, gjithë qejf, gjithë delikatesë, me ironi për të gjithë ata që ecnin kundër pasionit, punës e dëshirave të njeriut që kërkonte maksimumin për klientët e tij.*

Prandaj kjo karakteristikë e përhapur te shumë prej nesh, nuk arriti dot që të kthehej dot në pengesë të pakapërcyeshme për një njeri me natyrën dhe shpirtin e Vaskës. Ai ndërtoi diçka të bukur, që do të mbetej si shenjë identifikuese e njeriut që punon dhe krijon gjëra të veçanta që i mbeten njerëzve të qytetit. Vaska ua imponoi të bukurën dhe cilësinë klientëve të tij. Jo

më kot, por nuk kishte të dytë që të tërhiqej aq shumë pas të bukurës, sa Vaska. Atij i pëlqenin edhe gjërat më të vogla, por që dukeshin origjinale, që kishin një ngacmim që të linte shenjë brenda shpirtit. E kjo nuk ishte ndjeshmëria e një berberi që ushtronte këtë zanat prej dhjetëra vitesh.

Meraku tjetër më i madh i tiji, ishte perfeksioni. I donte gjërat e përkryera, pavarësisht gjithçkaje. Në sallon donte të kishte dritë, dritë, të shihte edhe detajin e fundit që do kapte gërshtëra... Rrallë gjen njerëz që të jenë aq të përqendruar për t'i bërë gjërat në maksimumin e tyre. Kjo e bënte Vaskën një njeri model, ai nuk punonte përgjysmë, nuk i bënte gjërat sa për të kaluar radhën. I jepej me mish e me shpirt gjithçka që merrte përsipër dhe e bënte siç duhej, deri në fund. Më tej, ai nuk e mendonte si biznes profesionin. Ai jepte gjithë kohën nga vetja, ky ishte një proces që i shijonte atij vetë. I zgjidhte klientët. Vaska e dinte që do të vinte në punë, do takonte miqësinë, do bënte bisedat që i pëlqenin, pra gjithçka ishte e programuar prej tij. Nuk kishte të papritura, dëshira e tij, ishte që të organizonte gjithçka. Të kishte gjithçka nën kontroll. Të mos linte asnjë paparashikueshmëri, që mund të trazonte normalitetin. Vaska donte që të mbante nën koordinimin e tij detajet e ditës. Por kjo ishte stres më vete, askush nuk e di atë që do të sjellë momenti në jetë.

Vaska nuk mërzitej edhe kur njerëzit tregoheshin të paduruar. E merrte me sportivitet gjithçka, ndaj nuk kishte asnjëherë konflikte me njeri. Ndërkohë, me

klientët e përhershëm, tregohej po aq hokatar, e nuk i kursente batutat dhe “kërcënimet”. Një mikun e tij që punon në Tiranë, kohë pas kohe e vinte në fron dhe i thoshte dhe mes tyre zhvillohej një skenë teatrale, që i jepte atmosferë sallonit. Vaska e rehatonte në kolltuk dhe me të filluar punën, klienti i ardhur nga larg e ngacmonte duke i thënë:

- Duket se po del edhe kësaj radhe më mirë se herën e kaluar, Vaskë!

Vaska, ia kthente aty për aty, pa ndalur kërciten e gërshërëve në ajër:

- He, he, sigurisht! S’kam ndër mend të të lë të dalësh nga këtu si çun Tirone, me ato qoshet që bëjnë ata berberët atje.

- Pa shiko, çfarë ke kundër berberëve të Tiranës?

Vaska, me ton të lehtë talljeje, duke tundur gishtin, e kërcënonte:

- Mos më bëj të flas më shumë se ç’duhet, se po të shoh një ditë të qethur keq nga ata, nuk ke për të hyrë më këtu! Ja kështu, do të të nxjerr nga dera e nuk të marr më në dorëzim. Mos guxo të shkosh te askush tjetër!

Klienti, duke qeshur me të madhe, ngrinte sytë në ajër, i dorëzuar:

- E po mirë, më binde! Ti e di që nuk shkoj askund, përveçse këtu! E ku mund të gjej një berber që lexon poezi e që vendos muzikë klasike në sfond? Por pa më thuaj, si po të shkojnë punët këto kohë?

Vaska që, ndihej mirë sa herë i vihej në të njëjtën hapësirë krahasimi muzika, letërsia dhe profesioni i tij, përgjigjej:

- Ah, si zakonisht, njeriu gjen kohë të kënaqet me atë që ka! Të gjithë duan të shpejtojnë, të gjithë nxitohen, por unë s'kam ngut! E marr me qetësi. Jeta duhet marrë me qetësi! Dhe me humor, buzëqeshja të mos mungojë! Përndryshe asgjë nuk ka kuptim!

- Të gjithë këtu të duan, e di? - pohonte duke tundur kokën tjetri. - Ti je gjithmonë në humor të mirë, edhe kur ka gjëra që të japin bezdi!

- E po, sekreti është ky: mos u zemëro kurrë! - e përmbyllte Vaska bisedën, pa e hequr buzëqeshjen nga goja. - E nëse është e mundur edhe kërcënimet për klientë të pabindur si ty, me buzëqeshje në buzë mund të bëhen!

Ja, dinte të krijonte situata dhe humor me të gjithë, ndaj njerëzit e donin dhe e vlerësonin të gjithë. Ambienti i punës ishte edhe hapësira e jetës, dita nuk kishte kuptim pa ata njerëz që hynin e dilnin, pa rregullin e krijuar, pa kujdesin për mirëmbajtjen e gjërave të vogla, që trajtoheshin me merak të madh, të ishin në vendin e duhur, siç i kishte hije një salloni me sqimë. Ndërkohë që bota jashtë rrotullohej me kaosin e jetëve që vetëm nxitonin e nuk linin asnjë shenjë të dukshme në shoqëri, mendojeni pak dhe ju: në një sallon me dritaret që shikonin nga bulevardi “Republika”, atje ku tinguj e muzikës derdheshin lehtë në ajër dhe përcillnin një ndjesi mirësie që i bënte hijeshi qytetit, ishte një njeri që kujdesej me gjithë shpirt për të bukurën dhe detajet me finesë të profesionit.

Ndaj natyra e këtij njeriu prekej lehtë dhe shqetësohej edhe për gjërat më të padukshme. Edhe detaji më i vogël, kishte rëndësi jetike për të. Kur bashkëshortja, Aida, përgatiste këmishën a bluzat, Vaska ndërhynte: “Po kjo vija kështu?” E merrte dhe e kontrollonte me imtësi këmishën, sikur kjo të ishte një procedurë që duhej të kryhej medoemos. Jo më kot, i donte gjërat të ishin të përkryera.

Aida e vështronte e habitur, mendohej të kuptonte kush ishte ai detaj që atë nuk e linte të ndihej mirë, por më pas dorëzohej. E njihte rutinën e Vaskës, edhe e kuptonte sa e vështirë ishte për të që të përshtatej me çrregullti të vogla, që për njerëzit e tjerë mund të ishin të papërfillshme. Kjo, nuk e bezdiste aspak. I tillë ishte bashkëshorti i saj, me trille të bukura, që e bënin të veçantë e të papërsëritshëm. Dhe nuk ishte vetëm rasti i saj që dëshmonte këtë nuancë të karakterit të Vaskës. Me atë, ndjeheshe sikur të ishte para komisionit të provimit në çdo situatë! Është një episod interesant, me detaje të vogla, por që tregojnë pak për natyrën nazelie dhe karakterin e qëmtuar të Vaskës. Pasi mbaroi një nga vizitat tek dentisti, ai u kthye i vrenjtur, me mërzinë që i lexohej në fytyrë. Nuk i la kohë askujt ta pyeste ç’kishte ndodhur, sepse u hap menjëherë: “E si të mos mërzitesh sot, me këto që na ndodhin çdo ditë? Ja, ma mori në qafë bluzën më të mirë!”.

Dentisti, gjatë punës, i kishte bërë pis e ia kishte prishur një nga bluzat e tij të preferuara, pastaj i kish kërkuar ndjesë, por ç’të mirë sillte kjo pas dëmit?

Kur e pa në atë gjendje, nga miqtë e tij, për ta zbutur situatën, u hodh dhe e këshilloi: “Ti kot sa mërzhitesh me kaq! Kur të vijë dentisti të qethet tek ty, kaloji me makinën qethëse nga një anë e kokës te tjera, e shfajësohu sa të duash pastaj...”

Veç ideja që Vaska mund të punonte me makinë qethëse e të sajonte atë “hata” në kokën e dentistit, bëri që edhe ai të qeshte, e ta kalonte lehtë atë situatë. Megjithatë, ky episod tregon sa shumë shqetësohej, edhe për gjëra të vogla, sepse bota e Vaskës duhej të ishte perfekte, gjithçka të ishte në vendin e duhur, asgjë të mos dilte nga rreshti i zakonshëm i saj.

Sot, mund të thuhet që njerëzit si Vaska nuk mund ta konsiderojnë dot jetën e plotë, pa pasion dhe emocion. Çdo ditë, ai e përjetonte ndryshe nga njerëzit e zakonshëm. Detaji për të është kryesori. I kënaqej gjërave më të vogla, por edhe trishtëhej nga vogëlimat që na ndodh t’i përjetojmë kohë pas kohe edhe ne. Njerëz si Vaska, jo gjithmonë arrinin që të kuptoheshin nga të tjerët. E duhet të kishe mençuri e finesë, që t’i përgjigjeshe edhe padrejtësive të jetës me elegancë dhe batutë.

Tani që Vaska është larguar, salloni i tij është një ambient që i përngjan një vendi të rrallë, e të papërsëritshëm. Ky sallon pat qenë më shumë se një vend pune; ai ambient ishte një strehë e ngrohtë, një ambient i përkushtimit dhe pasionit të tij të palodhur. Çdo klient që kalonte pragun e derës së tij, ndiente ngrohtësinë e mikpritjes, sigurinë e duarve të kujdesshme dhe ndershmërinë e një njeriu që jetonte

për profesionin e tij. Ata që arritën të ishin klientë të atij salloni të rregulluar me shije, e kuptonin që Vaska nuk ishte thjesht një berber. Ai ishte një artist, një filozof i jetës së përditshme që dinte të sillte bukurinë në çdo detaj.

Tani që Vaska nuk është më, Aida, bashkëshortja e Vaskës, vjen dhe kujdeset për lulet që e rruajnë akoma frymëmarrjen aty brenda. Ajo ka lënë të paprekur gjithçka, sikur Vaska të jetë larguar për një punë të vogël e s'do vonojë, do kthehet përsëri. Ndaj dhe sa herë që hapet dera e berberhanes, në ajër përhapet një aromë e këndshme, që të kujton Vaskën dhe buzëqeshjen e tij. Kush e ndjen aromën, e ka të lehtë të imagjinojë kërcitjet e lehta të gërshërëve, zërat që lidheshin në biseda të ngrohta, muzikën që dashur që emociononte shpirtin. E nëse imagjinon këto gjëra, e ke të lehtë të besosh që shpirti i tij vazhdon të jetë ende aty, duke mirëpritur me buzëqeshje dhe dashamirësi, familjen, klientët, shokët.